



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE  
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “NAZMI RUSHITI “DIBËR.

Nr. 196 prot.

Peshkopi, më 11 .09 .2024

**Lënda: Njoftim për lëvizje paralele**

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE  
TIRANË**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit:të ligjit nr.15/2017,datë 16.02.2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,të vendim të Këshillit të Ministrave nr. 554,datë 31.07.2019, “Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive datë si dhe Udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021 “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njesisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”,i ndryshuar

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale “ Nazmi Rushiti “ Dibër, ju njofton krijimin e vendit të lire : për pozicionin :

**-Mësimdhënës të teorisë profesionale,Drejtimi Shërbime Sociale dhe Shëndetësore,I(një mësimdhënës) në shkollën Bulqizë, me kohë të pjesshme (11orë/javë)**

**A-Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

**1 – Kriteret e përgjithshme:**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon ;

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon ;

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

### **B-Dokumentet e aplikimit**

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi

c) kartën e identitetit;

d) diplomë/dëftesën;

e) librezën e punës;

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

✓ *Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.*

✓ *Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara*

*Dokumentet e aplikimit dorëzohen në në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së,  
brenda datës 19 . 09 . 2024*

**DREJTORI**

**Majlinda POÇI**

